



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.28

Prishtinë, më 13.10.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Sinik.

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të MKRS –së OSBE-së, KDI- së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të dt.23.09.2015, 28.09.2015 dhe 05.10.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të dt.23.09.2015, 28.09.2015 dhe 05.10.2015.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;

Kryetari i Komisionit Nait Hasani tha se në dëgjimin publik të organizuar lidhur me Projektligjin për Kinematografinë, përfaqësuesit e fushës së kinematografisë dhe grupet e interesit, kanë propozuar disa vërejtje dhe sugjerime me qëllim të plotësimit dhe amendamentimit të projektligjit.

Komisioni, filloi me shqyrtimin nen për nen të Projektligjit, njëkohësisht duke shqyrtuar e vërejtjet e propozuara me shkrim, nga dëgjimi publik.

Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani